REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izlazna
Nr. -/-38 Data 28.03.2023
Br. Datum
OBILIQ-OBILIĆ

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opśtine Obilić - Municipality Assembly of Obilic

Në mbështetje të nenit 12.1, nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c), nenit 58 shkronja (h) dhe nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare nr.28 e dt.04.06.2008), neni 27 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 34 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 72, pika 1.8 dhe nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës së Obiliqit, nr.I-34, i dt.25.04.2016, si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës nr.-II-269, të dt.21.03.2023, në mbledhjen e mbajtur me dt.28.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Njësitë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Mazgit

Neni 1

Miratohet Vendimi për Shpalljen e interesit të përgjithshëm për shpronësimin e Njësive Kadastrale si në vijim :

- **P-72614046-00507-1**, Tipi i Pronës / Lloji i pronës: Pronë shoqërore/R ; Shfrytëzimi aktual/kultura-klasa:Bujqësore-Arat-Arë e klasës 2 me sipërfaqe prej 853 m²; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Mazgit; vendi i quajtur: Shestice e cila evidentohet në emër të **P.SH. KOMBINATI NDËRTIMOR RAMIZ SADIKU;**

- **P-72614046-00508-1**, Tipi i Pronës / Lloji i pronës: Pronë shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual/kultura-klasa:Tokë ndërtimore–oborr me sipërfaqe prej 2639 m²; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Mazgit; vendi i quajtur: Shestica e cila evidentohet në emër të **P.SH. KOMBINATI NDËRTIMOR RAMIZ SADIKU ;**

- **P-72614046-00509-1**, Tipi i Pronës / Lloji i pronës: Pronë shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual/kultura-klasa:Tokë tjetër – Jo pjellore me sipërfaqe prej 14043 m²; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Mazgit; vendi i quajtur: Shestice e cila evidentohet në emër të **P.SH.KOMBINATI NDËRTIMOR RAMIZ SADIKU ;**

- **P-72614046-00509-2**, Tipi i Pronës / Lloji i pronës: Pronëshoqërore/R ; Shfrytëzimiaktual/kultura-klasa: Tokë ndërtimore – Shtëpi-Ndërtesë me sipërfaqe prej 350 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Mazgit; vendi i quajtur: Shestice e cila evidentohet në emër të **P.SH.KOMBINATI NDËRTIMOR RAMIZ SADIKU ;**

- **P-72614046-00509-3**, Tipi i Pronës / Lloji i pronës: Pronë shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual/kultura-klasa: Tokën dërtimore – Shtëpi-Ndërtesë me sipërfaqeprej231 m²; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Mazgit; vendi i quajtur: Shestice e cilae videntohet në emër të **P.SH.KOMBINATI NDËRTIMOR RAMIZ SADIKU ;**

- **P-72614046-00509-9**, Tipi i Pronës / Lloji i pronës: Pronë shoqërore/R ; Shfrytëzimi aktual/kultura-klasa: Tokë ndërtimore – Shtëpi-Ndërtesë me sipërfaqeprej 250 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Mazgit; vendi i quajtur: Shestice e cila evidentohet në emër të **P.SH. KOMBINATI NDËRTIMOR RAMIZ SADIKU dhe;**

- **P-72614046-00509-11**, Tipi iPronës / Lloji i pronës:Pronëshoqërore/R; Shfrytëzimiaktual/kultura-klasa: Tokëndërtimore – Shtëpi-Ndërtesë me sipërfaqeprej110 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Mazgit;vendi i quajtur: Shestice e cila evidentohet në emër të **P.SH. KOMBINATI NDËRTIMOR RAMIZ SADIKU;**

Neni 2

Qëllimi i paraqitjes së këtij Vendim për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të njësive kadastrale të cekura si në nenin 1 të këtij Vendimi është Shpronësimi i këtyre Njësive Kadastrale për nevoja të Komunës së Obiliqit , në të cilat planifikohet realizimi i projekteve të ndryshme .

Vlera e kompensimit për pronën që do të shpronësohet do të caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 për miratimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme, që do të shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin .

Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria e Planifikimit Urban, Pronë dhe Kadastër, në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 do t'i drejtohet Qeverisë së Republikës së Kosovës (Departamentit të Shpronësimit) për fillimin e procedurës së shpronësimit.

Neni 4

Pas miratimit të këtij Vendimi për zbatimin e tij do të kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Planifikimit Urban,Pronë dhe Kadastër dhe Drejtoria e Financave .

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

-T'i dërgohet
-Kryetarit
-Nënkryetarit
- Kryesueses
-Anëtarëve të KK
- DPUKP
-MAPL
-Arkivit

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi